

11/12/2020

# PLANI I MARKETINGUT 2021

## *“Fuqizimi i Vlerave Tona”*

Elvira DUSHKU  
Sekretare e Përgjithshme/Federata e Basketbollit të Kosovës



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Përmbajtja

- Ballina
- Për Federatën e Basketbollit të Kosovës
- Vizioni, Misioni dhe Vlerat
- Pse është e rëndësishme për FBK-në ta ketë dhe ta implementoj një Plan të Marketingut?
- Mediat, marketingut dhe shërbimet e FBK-së/Faktet kryesore
- Objektivat
- Grupet e Interesit të FBK-së
- Analiza SWOT
- Strategjia
- Plani i Veprimit/ Kontrolli dhe Vlerësimi
- Përmbledhje
- Rekomandime



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Për Federatën e Basketbollit të Kosovës

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) është federata e dytë më e madhe në vendin tonë (pas Federatës së Futbollit të Kosovës).

FBK në gjirin e saj i ka rreth 114 klube, prej tyre rreth 74 sosh janë të kategorive të reja (U12, U14, U16, U18) në të dyja konkurrencat.

FBK në edicionin 2019/20 i ka numëruar 16 liga: *Superliga e Kosovës; Superliga e Femrave; Liga e Parë e Femrave; Liga e Parë e Meshkujve; Liga e Dytë e Meshkujve; Superliga U18; Liga Unike U18; Liga U16 Lindje; Liga U16 Perëndim; Superliga U16; Liga U16 Vajzat; Liga U14 Lindje; Liga U14 Perëndim; Liga U14 Vajzat; Liga U12 Lindje; Liga U12 Perëndim;*

Përveç ligave, FBK organizon edhe Kupën e Kosovës në të dyja konkurrencat dhe për të gjitha grupmoshat, si dhe Superkupën e Kosovës, në të dyja konkurrencat.

Në FBK janë të regjistruar:

- 1500 basketbollistë dhe basketbolliste;
- Prej tyre rreth 1000 të kategorive prej U12 deri në U18 në të dyja konkurrencat;

FBK gjatë një edicioni në nivel të garave vendore organizon:

- 400 ndeshje në kategorinë e seniorëve në të dyja konkurrencat;
- 750 ndeshje në kategoritë e reja në të dyja konkurrencat;

Përveç garave vendore që FBK i organizon, prej vitit 2015 kur edhe jemi anëtarësuar në FIBA, ne rregullisht marrim pjesë me Përfaqësuesen A të Kosovës dhe me Përfaqësuesen të Reja në garat zyrtare të FIBA-s.

Federata e Basketbollit të Kosovës në dy vitet e fundit i ka organizuar dy FIBA Kampionate Evropiane, ku në vitin 2018 ka qenë organizatore e FIBA U18 Kampionatit Evropian, Divizioni C, me ç'rast Kosova pati triumfuar dhe kështu është promovuar në Divizionin B, ku edhe aktualisht merr pjesë, derisa në vitin 2019, FBK ka qenë organizatore e FIBA U20

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Kampionatit Evropian, Divizioni B – Femrat dhe vitin e ardhshëm do të organizojë FIBA U16 Kampionatin Evropian, Divizioni C në Prishtinë.

Përveç me Përfaqësuese, Kosova në arenën ndërkombëtare paraqitet edhe në nivel të dy klubeve, së fundi në të dyja konkurrencat, derisa primatin e mbanë Sigal Prishtina, skuadër kjo që deri më tani e ka arritur suksesin më të madh në FIBA Europe Cup, duke zënë vend në mesin e 16 ekipeve më të mira të kësaj gare prestigjioze.

Federata e Basketbollit të Kosovës është pjesë e programeve të FIBA-s, siç janë TIME OUT Program, FECC, FIBA Europe Girls Program dhe FIBA Youth Development Program. Këto dy të fundit fokusin e kanë masivizimin e basketbollit ndër djem dhe vajza të reja.



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## VIZIONI

Për përparimin e basketbollit në Kosovë për tu bërë histori suksesi në të gjitha nivelet.

### *Çfarë do të thotë kjo:*

- Të arrijmë të regjistrojmë 4,000 anëtarë deri më 31 Dhjetor 2025;
- Të kualifikohemi me një ekip nacional të Kosovës (Meshkuj/Femra) në një garë të nivelit të lartë deri më 31 Dhjetor 2025;
- Ta bëjmë basketbollin sportin tonë më të dashur (nëpërmjet hulumtimeve);
- Të bëhemi financiarisht të qëndrueshëm. Deri më 31 Dhjetor 2025 të eliminojmë të gjitha borxhet.

## MISIONI

Për të qeverisur, zhvilluar dhe rritur sportin e basketbollit në Kosovë.

## VLERAT

**Ne synojmë të arrijmë misionin tonë nëpërmjet një grupi të qartë vlerash që na udhëheqin në të gjitha vendimet e marra në FBK:**

**Vizioni** - Jemi vizionarë, kreativë, kemi ëndrra të mëdha dhe gjithmonë mendojmë se si ta bëjmë basketbollin më tërheqës në vendin tonë për të gjithë anëtarët dhe grupet e interesit;

**Pasioni** - Jemi të apasionuarë pas basketbollit, komunitetit tonë dhe vendit tonë;

**Fitorja** - Jemi fitues dhe mundohemi të promovojmë dhe krijojmë mentalitet të fituesit tek lojtarët, zyrtarët, grupet e interesit dhe partnerët tanë;

**Respekti** - Respektojmë shumëllojshmërinë dhe lirinë e mendimit dhe gjithmonë udhëhiqemi nga parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës dhe përgjegjësisë;

**Zelli** - Punojmë me zell dhe angazhohemi për ta përmbushur misionin dhe vizionin dhe vizionit tonë, duke besuar se asgjë nuk e zëvendëson punën e zellshme.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## **Pse është e rëndësishme për FBK-në ta ketë dhe ta implementoj një Plan të Marketingut?**

Një plan efektiv i marketingut është thelbësor për të siguruar që Federata e Basketbollit e Kosovës dhe basketbolli kosovar të bëhen një qendër plot energji brenda bashkësisë sportive kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky pra është një element kryesor për të siguruar që sporti ynë të rritet.

Qasja jonë për një plan të suksesshëm të marketingut është analiza, sondazhet e tregut, hulumtimi, monitorimi dhe vlerësimi.

Prandaj ne do të iniciojmë planin tonë të marketingut me analizën e situatës dhe mjedisit dhe rishikimin e të gjitha aktiviteteve tona aktuale të marketingut.

Federata e Basketbollit të Kosovës duhet të ndryshojë të menduarit për marketingun, nga “një gjë e këndshme, në një domosdoshmëri brenda Federatës”.

Rëndësia e të paturit një Plan të Marketingut është natyrisht e pamohueshme.

Marketingu mund të ofrojë aq shumë për Federatën, por kjo mund të arrihet vetëm nëse punohet në mënyrë ekipore (Bordi + Komiteti Ekzekutiv+ Zyra Ekzekutive dhe Grupet e Interesit).

Ne duhet ta kemi të qartë dhe duhet të mësohemi me faktin se më e rëndësishme është "se çfarë FBK-ja mund të ofrojë", sesa "çfarë FBK mund të marrë".

Ne duhet të fokusohemi në atë se "çfarë mund të bëjmë dhe me kë për të krijuar rezultatet më të mira".

Pra përqëndrimi ynë duhet të jetë paralelisht edhe në krijimin e vlerave tona të përbashkëta me sponsorët apo partnerët potencial.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## **Mediat, Marketingu, Shërbimet/Faktet kryesore**

FBK ka një marrëveshje qendrore të të drejtave televizive për Superligën e Kosovës, që përfshinë edhe transmetimin e ndeshjeve të caktuara të Superligës së Femrave dhe ligave të tjera.

FBK ka faqe të verifikuara në Facebook me mbi 20K përcjellës, faqe të verifikuara në Instagram me rreth 6K përcjellës, kanal zyrtar në youtube dhe faqe të verifikuara në Twitter.

Klubet kryesore të Kosovës po ashtu kanë faqe zyrtare, jo të gjitha të verifikuara, në Facebook.

Basketbolli është sporti i dytë në Kosovë për nga numri i shkrimeve dhe postimeve në media, pas futbollit, por distanca ndërmjet vendit të parë dhe të dytë po rritet në dëm të basketbollit.

FBK ka uebfaqe zyrtare dhe mban komunikim të rregullt e shumë transparent me mediat dhe opinionin publik.

FBK ka sponsor qendror të ekipit kombëtar, sponsorë të ligave të kategorive të reja, kurse së fundi ka siguruar marrëveshje për sponsorim të Superligës së Kosovës.

FBK ka logo zyrtare, por nuk i ka të përfunduara elementet tjera të identitetit korporativ (skema e dizajnit për të gjitha platformat në internet, logot dhe fontet e veçanta për liga dhe kupa, skema e dizajnit të uniformave të ekipeve kombëtare dhe stafit, 3x3 etj).

FBK ka një sponsor teknik për nevojat e të gjitha ekipeve kombëtare.

Marketingu është një nga tri burimet e mëdha të të hyrave në FBK, bashkë me grantet qeveritare dhe grantet nga programet e FIBA-s.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Analiza SWOT

<p><b>Pikët e forta</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Kontrata qendrore afatmesme për të drejta TV;</li><li>- Kontrata me sponsorë të NT;</li><li>- Sponsorë që qëndrojnë përtej një kontrate;</li><li>- Sporti nr. 2 në mbulueshmëri mediale;</li><li>- Prezencë solide në rrjete sociale;</li><li>- Organizimi me sukses i FIBA eventeve;</li><li>- Imazhi i FBK-së dhe anëtarëve të saj;</li><li>- Rritja profesionale e stafit të zyrës ekzekutive;</li><li>- Zyrat dhe IT;</li></ul>	<p><b>Pikët e dobëta</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Mungesa e parave;</li><li>- Uebfaqja (mobile, stats, arkivi);</li><li>- Potenciali i pashfrytëzuar nga anëtarët;</li><li>- Gjeografia dhe demografia;</li><li>- Mungesa e identitetit korporativ;</li><li>- Klubet e paorganizuara;</li><li>- Marrëdhëniet klube - tifozë;</li><li>- Rënia e cilësisë dhe imazhi i ligës;</li></ul>
<p><b>Mundësitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ligji për sponsorim;</li><li>- Potenciali i pashfrytëzuar nga anëtarët;</li><li>- Gjeografia dhe demografia;</li><li>- Kërkesat specifike të sponsorëve;</li><li>- Basketbolli 3x3;</li><li>- Basketbolli në shkolla;</li><li>- Marrëveshjet bilaterale;</li><li>- Përvoja e menaxhmentit të FBK;</li></ul>	<p><b>Kërcënimet</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Gazetarët dhe sponsorët anojnë kah futbollen</li><li>- "Përrjashtimi" i njerëzve tanë;</li><li>- Shërbimet vetëm për "garues";</li><li>- Konkurrenca në raport me sportet tjera;</li><li>- Komunikimi i brendshëm;</li><li>- Zvogëlimi i "yjeve" vendore të ligës;</li><li>- Rëndësia e sportit në Komuna;</li><li>- Infrastruktura dhe mjedisi;</li><li>- COVID-19;</li></ul>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Objektivat

- Vazhdimi i punës në modernizimin e faqes zyrtare të FBK-së;
- Rritja e numrit të ndjekësve në mediat sociale të Federatës dhe fuqizimi i tyre;
- Çdo ditë të ketë artikull për basketbollin kosovar në mediat vendore;
- Një herë në javë të jetë i ftuar një nga zyrtarët më të lartë të FBK-së në televizionet tona;
- Publikimi i “Newsletter” (Bulletini Informativ) të FBK-së nga çdo tre muaj në çdo muaj për Grupet e Interesit të FBK-së;
- Publikimi i artikujve për basketbollin kosovar edhe në mediat ndërkombëtare;
- Kategorizimi i sponsorëve: Premium, i Artë dhe i Argjendtë;
- Fuqizimi i kampanjës për rritjen e interesimit për basketbollin femëror në Kosovë;
- Rishikimi i marrëveshjeve/kontratave me sponsorët/partnerët aktual dhe përgatitja e një analize dhe vlerësimi për ta (sponsorët me cash dhe me shërbime);
- Organizimi i aktiviteteve dhe kampanjave të përbashkëta me sponsorët dhe partnerët aktual;
- Zgjerimi i kampanjës për masivizimin e basketbollit femëror “Her World, Her Rules”;
- Rritja e të hyrave nga Qeveria;
- Rritja e të hyrave nga projektet;
- Rritja e numrit të sponsorëve (cash);
- Rritja e numrit të sponsorëve (me shërbime);
- Nënshkrimi i 3-4 marrëveshjeve bilaterale me Federatat Nacionale të Basketbollit;
- Rritja e shitjave të biletave për Përfaqësuesen A të Kosovës për ndeshjet e parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023;
- Gjenerimi i të hyrave nga FIBA Kampionati Evropian, Divizioni C, Prishtinë;
- Gjenerimi i të hyrave nga dyqani i FBK-së;

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E BASKETBOLLIT 2021-2025

### CILAT JANË GRUPET E INTERESIT TË FBK-së?

Basketbollistët/et	Klubet
Shkollat e basketbollit	Kuvendi
Bordi	Komiteti Ekzekutiv
Stafi	Vullnetarët
Drejtoritë Komunale të Sportit	Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport
Ministria e Arsimit	Komiteti Olimpik i Kosovës
FIBA/FIBA Europe	Federatat Nacionale
Sponsorët	Donatorët
Trajnerët	Referët
Delegatët	Mediat
Mjekët sportiv	Prindërit
Shikuesit	Federatat



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Strategjia

### *Fuqizimi i brendit*

- Punësimi i një zyrtari për marketing në FBK;
  - a) *Sigurimi i sponsorëve;*
  - b) *Rritja e imazhit të Përfaqësueses A të Kosovës;*
  - c) *Rritja e imazhit të Superligës së Kosovës;*
  - d) *Rritja e imazhit të Superligës së Femrave;*
  - e) *Rritja e imazhit të basketbollit femëror;*
  - f) *Fuqizimi i partneritetit me sponsorët tanë aktual;*



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

### ***Raporti me institucionet***

- *Fuqizimi i marrëdhënieve me Qeverinë qendrore dhe me qeveritë lokale;*
- *Fuqizimi i marrëdhënieve me KOK;*
- *Fuqizimi i marrëdhënieve me Federatat Sportive në Kosovë;*
- *Fuqizimi i marrëdhënieve me institucionet ndërkombëtare në Kosovë;*

### ***Raporti me mediat***

- *Ndërtimi i marrëdhënieve të forta me mediat nacionale nëpërmjet njoftimeve të shpeshta për shtyp;*
- *Fuqizimi i partneritetit me partnerin aktual medial, ArtMotion;*
- *Shfrytëzimi i faqes zyrtare të FBK-së për promovimin e basketbollit dhe FBK-së;*
- *Përkthimi i lajmeve në faqen zyrtare të FBK-së në gjuhën angleze;*
- *Sigurimi i "highlights" për mediat kosovare nga ndeshjet e Superligës së Kosovës, Final 8 të Kupës së Kosovës, si dhe aktivitete tjera promovuese për FBK-në;*

### ***Rritja e numrit të sponsorëve***

- *Sigurimi i sponsorit për Superligën e Femrave;*
- *Sigurimi i sponsorit gjeneral për FIBA U16 Kampionatin Evropian, Divizioni C në Prishtinë;*
- *Sigurimi i sponsorëve të tjerë për FIBA U16 Kampionatin Evropian, Divizioni C në Prishtinë;*
- *Sigurimi i sponsorit gjeneral (afatgjatë) për 5 Përfaqësueset e Reja;*
- *Sigurimi i partnershipit (afatgjatë) në projektet për zhvillim të generatave të reja në FBK;*

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

### ***Bashkëpunimi me Federatat Nacionale të Basketbollit***

- *Ofrimi i njohurive, si dhe mbështetje të nevojshme për federatat nacionale që kanë nevojë për një gjë të tillë;*
- *Zhvillimi i projekteve të përbashkëta me Federatat tjera Nacionale të Basketbollit;*
- *Organizimi i seminareve për referë dhe trajnerë në Kosovë dhe dërgimi i ftesave për referët dhe trajnerët ndërkombëtar;*

### ***Forcimi i marrëdhënieve tona ndërkombëtare***

- *Pjesëmarrja në evente të organizuara nga FIBA dhe FIBA Evropa;*
- *Vizita të ndërsjella me zyrtarë të FIBA-s dhe FIBA Evropës;*
- *Vizita të ndërsjella me zyrtarë të Federatave të tjera Nacionale;*
- *Pjesëmarrja në seminare, klinika për trajnerë dhe referë që organizohen nga FIBA, FIBA Evropa dhe Federatat tjera Nacionale;*
- *Edukimi i stafit të FBK-së në programe të FIBA-s, FIBA Evropës, KOK, KON, UEFA etj;*

### ***Promovimi i Ligave të Kosovës***

- *Përmirësimi i marrëdhënieve me klubet tona nëpërmjet takimeve më të shpeshta dhe projekteve të përbashkëta;*
- *Organizimi i seminareve për menaxhim dhe qeverisje të mirë për klubet tona;*
- *Asistimi i klubeve tona në realizimin e kërkesave të tyre kundrejt ministrisë apo institucioneve të tjera lokale apo qendrore;*
- *Shpërblimi i klubeve për të arriturat e tyre brenda një edicioni;*

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

### ***Krijimi i produkteve të reja***

- *Fuqizimi i Ligës UNIKE;*
- *Zhvillimi i Mini-Basketbollit në Kosovë;*
- *Zhvillimi i basketbollit 3x3 në bashkëpunim me shkollat fillore dhe të mesme;*
- *Organizimi i turneve të basketbollit për vajza në bashkëpunim me shkollat fillore;*
- *Organizimi i një eventi brenda vitit për sponsorë – partnerë të FBK-së;*
- *Organizimi i aktiviteteve social-edukative për basketbollistët /basketbollistet e Përfaqësueseve të Kosovës dhe të projekteve të FBK-së;*
- *Shfrytëzimi i basketbollistëve /eve (ambasadorë) në evente të ndryshme me FBK-në dhe me sponsorë /partnerë aktual dhe potencial;*
- *Lidhshmëria e kampanjave të marketingut të Përfaqësueses së Meshkujve me atë të Femrave për më shumë ekspozim;*
- *Planifikimi dhe ekzekutimi i fushatave të reja të marketingut për përgjegjëse sociale;*
- *Përdorimi i platformave të mediave sociale për të angazhuar vajza të reja në të gjithë Kosovën;*



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

### Plani i Veprimit

<b>Veprimi (Çfarë)</b>	<b>Detyra (Si)</b>	<b>Përgjegjësi (Kush)</b>	<b>Afatet (Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Përgatitja e Planit të Marketingut</i>	<i>Pas diskutimeve me Bordin dhe KE</i>	<i>Zyrtari i Marketingut</i>	<i>Janar – Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS Sponsorët FIBA</i>

### Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Fuqizimi i FBK-së dhe basketbollit kosovar</i>	<i>FBK Zyra Ekzekutive</i>	<i>Sigurimi i një stabiliteti financiar në FBK</i>	<i>Në bazë të analizave të bëra, hulumtimeve, raporteve</i>	<i>Në baza mujore, vjetore</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Rekomandime

Është e rëndësishë së veçantë që Bordi i FBK-së, Komiteti Ekzekutiv dhe Zyra Ekzekutive ta marrin seriozisht qasjen ndaj implementimit të këtij plani, sepse vetëm në këtë mënyrë të gjitha ato që janë shkruar në këtë plan mund të realizohen dhe në fund të vitit do të kemi një bilanc mes të asaj se a do të ishte më mirë të punojmë me një Plan të Marketingut apo pa të.

Ne besojmë fuqishëm se basketbolli është një platformë dhe nxitës për ndryshim. Çdo gjë që ne e bëjmë në Federatën e Basketbollit të Kosovës ka ndikim në mijëra njerëz, si dhe ka ndikim në zhvillimin e vendit tonë. Është përgjegjësia jonë për të vazhduar punën për rritjen e ndikimit të sportit tonë.

Federata e Basketbollit të Kosovës si institucion serioz dhe përgjegjës kryesor për zhvillimin e basketbollit në vendin tonë, do të duhej të jetë si rol model në të ardhmen, jo vetëm për për klubet dhe gjithë anëtarët e saj, por edhe për të gjitha Federatat Sportive në vendin tonë.

Është e rëndësishë së veçantë që klubet e basketbollit dhe shkollat, apo shoqatat anëtare të saj të marrin shembull nga FBK, dhe në këtë mënyrë të vazhdojnë edhe ato me hartimin dhe implementimin e Planit të Marketingut.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Përmbledhje

Ky plan i marketingut është një dokument gjithëpërfshirës që përshkruan objektivat afatgjatë të marketingut për një deri në dy vitet e ardhshme. Plani përshkruan aktivitetet e biznesit të përfshira në përmbushjen e objektivave specifike të marketingut brenda një afati kohor të caktuar.

Ky plan marketingu përfshinë gjithashtu një përshkrim të pozicionit aktual të marketingut të Federatës, një diskutim të tregut të synuar dhe një përshkrim të miksit të marketingut që Federata do të përdorë për të arritur qëllimet e marketingut.

Ai përmban disa të dhëna historike, parashikime në të ardhmen dhe metoda ose strategji për të arritur objektivat e marketingut. Plani i marketingut tregon hapin ose veprimet që do të përdoren për të arritur qëllimet e planit.

Promovimi dhe marketingu i sportit tonë është absolutisht thelbësor për rritjen dhe suksesin e qëndrueshëm.

Qasja jonë është bashkëpunuese dhe krijuese, si dhe do të sjellë përfitime për të gjithë komunitetin e basketbollit.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)

